

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Historia tragjike e gruas italiane/ Luftoi mafien për vrasjen e nënës së saj dhe denoncoi të atin, gjendet e pajetë në moshën 35-vjeçare
ADRESA	https://piranjat.al/bota/historia-tragjike-e-gruas-italiane-luftoi-mafien-per-n-e-nenes-se-saj-i103807
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 14:25:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 14:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	148cb3bcb44b2d62654c4307e8e93eb53a21f5d03d74a76d56e10ad7cb466eb5
TEKSTI	7fba14a99db8cace1cfcf78cd67036ae9ec29a9f1607b0548d87ca228cd390eaa
PAMJA	a3c302188c072c8a78557873cc37840807a6ad164b63512d74757a660b7be910

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7c5d10d9cca32412fb271390a09556e939d5c8b97ff0863518ad137bbec1a76d
E MËPARSHMJA	0e49b7c6e2130c409e0f4fcf619da19eff20dfdc2ff360a832f37d286d2ed3d9
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7c5d10d9cca32412fb271390a09556e939d5c8b97ff0863518ad137bbe1a76d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

 [SYRI LIVE](#)



Flash: me ripërtëritë të ijetës

ne një prononcim të shkurtër nga Rimasi

shqiptarit të zhvilluar në Greqi, ku u kërkuar

datin në protestë dhe

të Memaliajt dolën në aksin

që përdorën bashkëpunëtorët

rreth një orë larg Serresit

pse SPAK nuk sjell në

Gazment Bardhi publikoi videon e deklaratis së

rru

 BOTA

Historia tragjike e gruas italiane/ Luftoi mafien për vrasjen e nënës së saj dhe denoncoi të atin, gjendet e pajetë në moshën 35-vjeçare

Piranjat Përditësimi i fundit 12 Shtator 2026, 16:17



 Historia tragjike e gruas italiane/ Luftoi mafien për vrasjen e

Shtatëmbëdhjetë vjet pasi nëna e saj u vra nga mafia e pamëshirshme kalabreze, Denise Garofalo i dha fund jetës, në moshën 35-vjeçare, në të njëjtën moshë që ishte Lea Garofalo kur u vra.

Denise ishte një nga figurat më simbolike në historinë e luftës kundër mafias italiane. Ajo ishte vajza e gruas që vendosi të thyente ligjin e heshtjes dhe të denonconte aktivitetet e ish-partnerit të saj dhe shefit të mafias, duke paguar në fund me jetën e saj për këtë zgjedhje.

Vite më vonë, vetë Denise do të ndiqte gjurmët e nënës së saj. Ajo dëshmoi kundër babait të saj, Carlo Cosco-s, dhe luajti një rol të rëndësishëm në dënimin e personave të përfshirë në vrasjen e nënës së saj.

Vrasja e Lea Garofalos

Lea Garofalo u vra më 24 nëntor 2009, me urdhër të ish-partnerit të saj, Carlo Cosco. Ajo kishte lindur në Petilia Policastro, në Kalabri, dhe kishte vendosur të bashkëpunonte me autoritetet, duke dëshmuar për aktivitetet e paligjshme të klanit mafioz, të cilat përfshinin trafikun e drogës, vrasjet dhe aktivitetet e grupeve mafioze nga Kalabria deri në Milano.

Që nga viti 2002, ajo kishte qenë pjesë e një programi për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe jetonte nën një identitet tjetër, me organizatën Libera në krah të saj.

«Po e bëj për vajzën time», u tha ajo autoriteteve, duke shpjeguar vendimin e saj për të bashkëpunuar.

Ishte pikërisht marrëdhënia e saj me Denise-n ajo që, siç doli më vonë, u përdor për ta joshur. Ish-partneri i saj e bindi të takohej me të në Milano, duke pretenduar se donte të fliste për vajzën e tyre.

Imazhet e fundit të Leas u kapën nga kamerat e sigurisë në zonën e Arco della Pace, në Milano. Më pas ajo u rëmbye, u vra dhe trupi i saj u shpërbë. Mbetjet e saj u zbuluan rreth tre vjet më vonë.

Denise dëshmoi kundër babait të saj

Për Denise-n, goditja ishte e dyfishtë. Përveç zbulimit të fatit të tmerrshëm të nënës së saj, ajo u përball me faktin se babai i saj dhe i riu me të cilin kishte nisur një lidhje ishin arrestuar për vrasjen.

Në fakt, ishte partneri i saj i atëhershëm ai që ndihmoi autoritetet të gjenin eshtrat e Leas.

Në gjyqin e zhvilluar në Gjykatën Penale të Milanos, Denise dëshmoi e mbrojtur pas një ekрани dhe me mbështetjen e avokatit të saj. Pavarësisht presionit dhe përpjekjeve për ta frikësuar, ajo akuzoi drejtpërdrejt të atin.

Dëshmia e saj rezultoi vendimtare në zhvillimin e çështjes dhe në dënimin me burgim të përjetshëm që pasoi.

Ashtu si nëna e saj, Denise zgjodhi të bashkëpunonte me autoritetet dhe të paraqitej si palë civile në gjyqin kundër babait të saj dhe bashkëpunëtorëve të tij.

Denise mbeti nën mbrojtje deri në vitin 2018. Ajo jetoi me një identitet tjetër, arriti të punonte dhe u përpoq ta ndërtonte jetën e saj nga e para, nën mbrojtjen e shërbimeve kompetente.

Ajo kishte edhe një fëmijë, ndërsa më vonë punoi në shërbimin publik.

Trauma e asaj që kishte përjetuar, megjithatë, mbeti e thellë.

Më 6 shtator, 35-vjeçarja u përpoq t'i jepte fund jetës në Ariccia, në periferi të Romës. Ajo u shtua në spital për katër ditë, por përfundimisht ndërroi jetë.

Hetimi për nxitje të vetëvrasjes

Prokuroria e Velletrit ka hapur tashmë një hetim ndaj personave të panjohur, për mundësinë e nxitjes së vetëvrasjes. Si pjesë e hetimit, pritet të merret në pyetje partneri i saj, i cili ndodhej në shtëpi dhe ishte në gjendje shoku kur ndodhi incidenti. Autoritetet kanë urdhëruar gjithashtu një ekspertizë dixhitale të telefonit të saj celular.

Qëllimi i hetuesve është të rindëtojnë ditët e fundit të jetës së saj dhe të përcaktojnë nëse ka pasur ndonjë ngjarje, komunikim apo presion që mund të ketë qenë i lidhur me vendimin e saj.

Denise Garofalo ndërroi jetë pasi kaloi pothuajse të gjithë jetën e saj të rritur nën hijen e një krimi që tronditi Italinë. Dëshmia e saj kishte kontribuar në vendosjen e drejtësisë për nënën e saj, duke e shndërruar atë në një simbol të rezistencës kundër mafies. /PiranjatNews/

Artikuj te sugjeruar

BOTA 12 Shtator16:00

[Alarmi klimatik, gushti 2026 ndër muajt më të nxehtë në botë](#)

Gushti i sivjetshëm ishte muaji më i nxehtë i regjistruar ndonjëherë në botë, me temperaturat globale 1,65 gradë Celci...

Piranjat News BOTA 12 Shtator15:09

[Dokumentet e deklasifikuara tregojnë se Mbretëria e Bashkuar ishte në dijeni të krimeve të luftës izraelite](#)

Diplomatët britanikë dënuan sjelljen izraelite në Bregun Perëndimor të pushtuar si një model të shkeljeve të t&eu...

Piranjat News BOTA 12 Shtator12:13

[VIDEO/ Shpërthim në një depo armësh në Bullgari, dyshohet se pas ngjarjes fshihen disa agjentë rusë](#)

Një shpërthim shkaktoi zjarr në një depo armësh në Bullgarinë qendrore gjatë natës, raportuan...

BOTA 11 Shtator23:50

[Konflikti/ Putin: Trupat evropiane në Ukrainë do të nënkuptonin luftë me Rusinë](#)

Presidenti rus Vladimir Putin ka paralajmëruar se vendosja e trupave evropiane në territorin e Ukrainës do të konsiderohej nga Moska si p&eu...

BOTA 11 Shtator23:20

[VIDEO/ Treni del nga shinat në Francë, rreth 20 të lënduar](#)

Një tren pasagjerësh me rreth 180 persona në bord ka dalë nga shinat mbrëmjen e sotme pranë qyteteve Cléon dhe Tourville-la...

BOTA 11 Shtator23:07

[Lë nënën në dyshemenë e banjës për dy javë mes insekteve, djali 56-vjeçar dënohet me burg pas vdekjes së saj](#)

Një djalë që e la nënën e tij në dyshemenë e banjës, mes një infestimi me insekte, për dy javë, është...

BOTA 11 Shtator22:03

[Paralajmërimi: Një sulm i ri i ngjashëm me 11 shtatorin mund të jetë duke u përgatitur](#)

Kreu i agjencisë britanike të spiunazhit, MI5 ka paralajmëruar se një goditje e re, e ngjashme me sulmet e 11 shtatorit, mund të jet&eu...

BOTA 11 Shtator21:56

[Europol godet rrjetin e dyshuar të trafikimit të kuajve në Evropë](#)

Europol ka mbështetur një operacion ndërkombëtar kundër një rrjeti kriminal të dyshuar për trafikimin e kuajve në E...

BOTA 11 Shtator21:28

[Britania zgjeron sanksionet ndaj vendbanimeve izraelite, përfshihen Jerusalemi Lindor dhe Golanet](#)

Sanksionet e Britanisë së Madhe ndaj vendbanimeve izraelite në Bregun Perëndimor të pushtuar do të përfshijnë edhe vendb...

BOTA 11 Shtator21:11

[Filmi horror që Vatikani e dënoi si "fyerje"/ 55 vjet më vonë po shfaqet ligjërisht për herë të parë](#)

Një nga filmat horror më të diskutueshëm në historinë e kinemasë britanike po rikthehet në kinema,&n...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 12 Shtator

[Pritë me armë në Greqi, 'policët' e rremë bllok...](#)

Një arratisje spektakolare ka ndodhur mbrëmjen e së premtes në Greqi, gjatë transferimit të një të burgosuri nga Burgu...

SHOWBIZ 11 Shtator

[VIDEO/ Dalin pamjet, ky është i dashuri i Franç...](#)

Gazetari Elton Tozaj ka rikthyer sërish në vëmendje jetën private të personazheve të showbiz-it. Këtë herë, n&eu...

SHOWBIZ 11 Shtator

["Kaq ishte, por ishte kënaqësi", Noizy mbyll nj...](#)

Reperi shqiptar, Noizy, ka njoftuar një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën se si do të vazhdojë aktivitetin e ...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!



Reagon Cllevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!



7 September 2026



Pamje apokaliptike nga Puka!



7 September 2026



Aida, piranja jonë e parë, rikthehet në skuadër më e motivuar se kurrë për të kapur maniakët.



Qytetarët na frymëzojnë çdo ditë. Bisedat e mikpritja e tyre na japin motiv për punën me pasion.



Luela Gaxhja, “stari” i Piranjave, që kërkon çdo ditë rritje rroge.



5 September 2026



5 September 2026



Florian Binaj rikontirmon: Do kandidoj serish si kandidat i pavarur



Edon Kuqi/Piranja jonë politike që ngatërroi ëndrrën e gazetarit me atletin 100m.



Dyshime për zjarrvënje të qëllimshme



Humbi jetën në aksidentin tragjik, një muaj më parë i propozoi për martesë.



Qytetarja denoncon me video ngacmimin ne autobus. #news



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Gruaja me dy identitete që premtën “shërim” me ujë e kufomave në Pejë



A ka Shqipëria një Nicola Gratteri?



Katër nëna në kërkim të fëmijeve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët



Flamur Gjuzi, i dënuar për"shpërdorim detyre" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?



Pallatet u zhytën“Durrës Marina” dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit



Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 15



Enkel Demi duke luftuar paragjykimet për shqiptarët. (kamera e fshehtë)



Milva Ekonomi i firmosi miliona euro Vilma Nushit, kjo e fundit i investoi te kulla e Ervin Matës



Ajo çfarë mund të na mësojë Kosova.



Laboratorë “copy-paste”/ I njëjti mjek firmos analiza në disa pika, skema që ngre pikëpyetje



Rrjeti i ‘errët’ i vajzave të zhdukura! Bisedat tronditëse si funksiononte grupi.



Bleu 300 m2 tokë në vitin 2004, kthehet nga emigrimi dhe gjen aty vilë 3-katëshe.



“Na detyruan nga Dubai”/ Konstruktori i Durrës Marina zbulon pse u zhytën pallatet



Drejtori që tregon sjellje të pahijshme me nxënësen: Jam i fortë edhe në parti



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 14



Turisti zemërgjerë nga Italia dhe patatinat falas



Aksidentet “pushtojnë” oborrin e familjes në Klos, banori: Një ditë do ndodhë tragjedi



Lidhja jashtëmartesore që përfundoi në makth /32-vjeçarja rrëfen shantazhin me video intime



Sherr në terminalin e Peshkopisë, shoferi: Mos më vidh pasagjerët! Shko ha bukë te pjesa jote



Artisti dhe Frika



Si u kthye në urrejtje dashuria mes ish-bashkëshortëve dhe ‘lufta’ për 200 mijë euro!

